



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Arsen Muskurti** me datë **05.12.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Shfuqizimin e vendimit me nr. 125, datë 13.11.2024, me nr. 2658 Prot., të Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve”.

2. Në përfundim të gjyimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtare Irena Gjoka, bazuar në nenet 83 e vijues, 112, 415, 470 të K.Pr.Penale, nenit 67, pika 3 e Ligjit 81/2020, si dhe vendimit njehsues nr. 1670, datë 26.10.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me vendimin Nr. **702**, datë **24.12.2024**, vendosi:

1. Shpalljen e moskompetencës lëndore, për gjykimin e kërkesës penale me nr.702 Regj.Themeltar, datë regj.05.12.2024, me palë kërkuese: **Arsen Muskurti**, me objekt: “*Shfuqizimin e vendimit me nr.125, datë 13.11.2024 me nr.2658 Prot, të Komisionit të Apelimit të Masave Disiplinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve*”, si dhe dërgimin e kësaj kërkesë për kompetencë, gjykatës kompetente, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
2. Ngarkohet kryesekretaria pranë kësaj gjykate që të kryejë veprimet përkatëse, duke ia dërguar fashikullin objekt i këtij gjykimi, gjykatës kompetente, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Tiranë, më datë 24.12.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar